LIGJ
Nr. 11/2015

PËR ADERIMIN E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË NË MARRËVESHJEN SHUMËPALËSHE NDËRMJET VENDEVE TË EUROPËS JUGLINDORE PËR ZBATIMIN E KONVENTËS "PËR VLERËSIMIN E NDIKIMIT MJEDISOR NË KONTEKST NDËRKUFITAR"

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Republika e Shqipërisë aderon në marrëveshjen shumëpalëshe ndërmjet vendeve të Europës Juglindore për zbatimin e konventës "Për vlerësimin e ndikimit mjedisor në kontekst ndërkufitar" (ESPOO).

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 19.02.2015

Shpallur me dekretin nr. 8993, datë 6.3.2015 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bujar Nishani

MARRËVESHJE SHUMËPALËSHE
NDËRMJET SHTETEVE TË EUROPËS JUG LINDORE PËR ZBATIMIN E KONVENTËS PËR VLERËSIMIN E NDIKIMIT MJEDISOR NË KONTEKST NDËRKUFITAR

Palët e kësaj Marrëveshjeje,
duke marrë parasysh se jo të gjitha palët e kësaj Marrëveshjeje janë palë në Konventën e Vlerësimit të Ndikimit Mjedisor në Kontekst Ndërkufitar,
duke dëshiruar të zbatojnë hollësisht dispozitat e kësaj Konvente,
kanë rënë dakord sa më poshtë:

Neni 1

Për qëllimet e kësaj Marrëveshjeje,
1. "Palë" nënkupton, nëse konteksti nuk përcakton ndryshe, një Palë Kontraktuese në këtë Marrëveshje.
2. "Palë e Origjinës" nënkupton Palën ose Palët Kontraktuese në këtë Marrëveshje nën juridiksionin e së cilës është parashikuar të zhvillohet një aktivitet i propozuar.
3. "Palë e Cenuar" nënkupton Palën ose Palët Kontraktuese në këtë Marrëveshje që mund të preken nga ndikimi ndërkufitar i një aktiviteti të propozuar.
4. "Palë të interesuara" nënkupton Palën e Origjinës dhe Palën e Cenuar të një vlerësimi të ndikimit mjedisor në zbatim të kësaj Marrëveshjeje.
5. "Aktivitet i propozuar" nënkupton çdo aktivitet ose çdo ndryshim kryesor të ndonjë aktiviteti

në bazë të një vendimi të një autoriteti kompetent, në përputhje me procedurat e zbatueshme kombëtare.

6. "Aktivitet i propozuar i përbashkët" nënkupton një aktivitet të propozuar që është parashikuar të zhvillohet nën juridiksionin e më shumë se një Pale.

7. "Vlerësim i ndikimit mjedisor" nënkupton një procedurë kombëtare për vlerësimin e ndikimit potencial në mjedis të një aktiviteti të propozuar.

8. "Ndikim" nënkupton çdo efekt të shkaktuar në mjedis nga një aktivitet i propozuar, duke përfshirë shëndetin dhe sigurinë e njerëzve, florën, faunën, tokën, ajrin, ujin, klimën, peizazhin dhe monumentet historike apo struktura të tjera fizike ose ndërveprimi midis këtyre faktorëve; përfshin gjithashtu efektet në trashëgiminë kulturore ose kushtet social-ekonomike që rezultojnë nga ndryshimet e këtyre faktorëve.

9. "Ndikim ndërkufitar" nënkupton çdo ndikim jo vetëm të një karakteri global, brenda një zone nën juridiksionin e një Pale, të shkaktuar nga një aktivitet i propozuar, origjina fizike e të cilit është vendosur tërësisht ose pjesërisht brenda zonës nën juridiksionin e një Pale tjetër.

10. "Autoritet kompetent" nënkupton autoritetin kombëtar ose autoritetet e përcaktuara nga një Palë si përgjegjëse për kryerjen e detyrave të mbuluara nga kjo Marrëveshje dhe/ose autoriteti apo autoritetet e besuara nga një Palë me fuqi vendimmarrëse në lidhje me një aktivitet të propozuar.

11. "Pikë e kontaktit" nënkupton një person përgjegjës për dërgimin dhe marrjen e njoftimeve sipas kësaj Marrëveshjeje.

12. "Publik" nënkupton një ose më shumë persona fizikë ose juridikë dhe në përputhje me legjislacionin ose praktikën kombëtare, shoqatat, organizatat ose grupet tyre.

13. "Konventë" nënkupton Konventën për Vlerësimin e Ndikimit Mjedisor në Kontekst Ndërkufitar, të hartuar në ESPOO (Finlandë) në datën 25 shkurt të vitit 1991.

Neni 2

1. Çdo Palë cakton autoritetin e tyre kompetent dhe pikën e kontaktit, dhe si rrjedhojë informon Palët e tjera të kësaj Marrëveshjeje dhe sekretariatin e Konventës brenda 30 ditëve nga data e hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje.

2. Brenda 30 ditëve nga çdo ndryshim i mëvonshëm i autoritetit të tyre kompetent apo në pikën e kontaktit, çdo Palë do të informojë rrjedhimisht Palët e tjera të kësaj Marrëveshjeje dhe sekretariatin e Konventës.

Neni 3

Palët marrin masat e nevojshme ligjore, administrative ose masa të tjera për zbatimin e dispozitave të Konventës ndërmjet tyre.

Neni 4

Secila Palë merr masat e nevojshme ligjore, administrative ose masa të tjera për zbatimin e dispozitave të kësaj Marrëveshjeje për aktivitetet e propozuara të renditura në shtojcën I të Konventës që mund të shkaktojnë ndikim të rëndësishëm negativ ndërkufitar.

Neni 5

1. Palët miratojnë kriteret për identifikimin e ndikimit të rëndësishëm negativ ndërkufitar, në bazë të kritereve të përgjithshme të përcaktuara në shtojcën III të Konventës.

2. Palët zhvillojnë udhëzime për zbatimin e kësaj Marrëveshjeje në bazë të elementeve të mëposhtme, midis të tjerash: shfaqjen, njoftimin, konfirmimin e pjesëmarrjes, transmetimin e informacionit, përgatitjen e dokumentacionit të vlerësimit të ndikimit mjedisor dhe shpërndarjen e tij, pjesëmarrjen

publike, konsultimet ndërmjet Palëve, vendimin dhe transmetimin e vendimit përfundimtar, post-projekt analizën dhe përkthimin.

3. Kriteret e miratuara në përputhje me paragrafin 1 përdoren për zhvillimin e udhëzimeve të parashikuara në paragrafin 2.

Neni 6

1. Për një aktivitet të përbashkët të propozuar, secila prej Palëve nën juridiksionin e të cilave është parashikuar të zhvillohet aktiviteti i propozuar, konsiderohet si Pala e Origjinës dhe Pala e Cenuar. Këto Palë formojnë një ose më shumë grupe të përbashkëta pune për të përcaktuar masat e hollësishme për komunikim dhe konsultime.

2. Kur këto palë bien dakord, nenet 7 deri 11 nuk zbatohen për aktivitetin e përbashkët të propozuar për ato palë.

Neni 7

1. Pika e kontaktit të Palës së Origjinës, kur vihet në dijeni se aktiviteti i propozuar parashikohet nga neni 4, duhet të njoftojë pa vonesë pikën e kontaktit të Palës së Cenuar.

2. Nëse legjislacioni kombëtar i vlerësimit të ndikimit mjedisor i Palës së Origjinës përfshin një fazë fillestare, pika e kontaktit e Palës së Origjinës duhet të njoftojë pikën e kontaktit të Palës së Cenuar në atë fazë ose më herët.

3. Pika e kontaktit e Palës së Cenuar duhet t'i përgjigjet pikës së kontaktit të Palës së Origjinës brenda 30 ditëve nga momenti që merr njoftimin dhe duhet të përcaktojë nëse Pala e Cenuar synon të marrë pjesë në procedurat e vlerësimit të ndikimit mjedisor.

4. Njoftimi duhet të përmbajë informacionin e përfshirë në aneks.

5. Nëse Pala e Cenuar përcakton se nuk synon të marrë pjesë në procedurat e vlerësimit të ndikimit mjedisor ose nuk përgjigjet në kohë, dispozitat në nenet 9 deri 14 nuk do të zbatohen.

Neni 8

1. Pala e Origjinës duhet të vërë në dispozicion njoftimin në gjuhën angleze dhe të specifikojë nëse përgjigja duhet të jetë në gjuhën angleze.

2. Pala e Cenuar duhet t'i përgjigjet njoftimit për të dhënë informacion në lidhje me mjedisin potencial të prekur dhe për të dhënë komentet e publikut dhe të autoriteteve të Palës së Cenuar, në gjuhën angleze, nëse kërkohet nga Pala e Origjinës.

3. Pala e Cenuar mund të specifikojë që komunikime të mëtejshme dhe dokumentacioni i vlerësimit të ndikimit mjedisor do të vihen në dispozicion në gjuhën angleze.

4. Dokumentacioni i mëposhtëm duhet të përkthehet nga propozuesi i aktivitetit të propozuar në gjuhën zyrtare të tij dhe të specifikohet nga Pala e Cenuar:

a) Përshkrimi i aktivitetit të propozuar dhe qëllimi i tij;

b) Përmbledhja joteknike;

c) Përshkrimi i ndikimit potencial të mjedisit ndërkufitar të aktivitetit të propozuar dhe alternativat e tij dhe një vlerësim të rëndësisë së tij;

d) Përshkrimi i masave zbutëse për të ruajtur në nivel minimal ndikimin ndërkufitar mjedisor negativ.

Neni 9

Palët e interesuara mund të formojnë një ose më shumë grupe të përbashkëta pune për komunikime të mëtejshme dhe shkëmbimin e informacionit ndërmjet Palëve të interesuara.

Neni 10

1. Autoriteti kompetent i Palës së Origjinës do të konsultohet me autoritetin kompetent të Palës së Cenuar, nëpërmjet grupeve të përbashkëta të punës, nëse janë krijuar, në marrëveshje për shpërndarjen e dokumentacionit të vlerësimit të ndikimit mjedisor për autoritetet dhe publikun e Palës së Cenuar, duke përfshirë:

a) Numrin e kopjeve të dokumentacionit të vlerësimit të ndikimit mjedisor, të nevojshme për Palën e Cenuar si dhe në marrëveshjet e veçanta, të tilla si vendndodhja dhe koha, për marrjen e dokumentacionit të vlerësimit të ndikimit mjedisor në dispozicion të publikut të Palës së Cenuar;

b) Nëse komentet e dorëzuara nga publiku i Palës së Cenuar do t'i dërgohen drejtpërdrejt autoritetit kompetent të Palës së Origjinës, ose nëse ata do të pranohen nga autoriteti kompetent i Palës së Cenuar dhe më pas kalojnë në tërësinë e tyre tek autoriteti kompetent i Palës së Origjinës.

2. Për të garantuar një proces në përputhje me kohën e procedurës së vlerësimit të ndikimit mjedisor kombëtar të Palës së Origjinës, Palët e interesuara do të kërkojnë që të paraqitet dokumentacioni i vlerësimit të ndikimit mjedisor tek autoritetet dhe te publiku i Palës së Cenuar paralelisht me dorëzimin e tij tek autoritetet dhe publiku i Palës së Origjinës.

Neni 11

Dokumentacioni i vlerësimit të ndikimit mjedisor duhet të përmbajë minimalisht informacionin e përshkruar në shtojcën II të Konventës.

Neni 12

Palët do të sigurojnë që vendimi përfundimtar për veprimtarinë e propozuar specifikon se si komentet nga publiku dhe autoriteteve të Palës së Cenuar janë marrë në konsideratë. Komentet duhet të trajtohen në mënyrë të barabartë dhe pa marrë parasysh kufijtë kombëtarë.

Neni 13

Nëse legjislacioni i Palës së Origjinës përfshin mundësinë për publikun apo autoriteteve nga Pala e Cenuar që të kenë akses në procedurat administrative ose gjyqësore për të kundërshtuar vendimet përfundimtare mbi një aktivitet të propozuar, vendimi përfundimtar do të përfshijë informacion në lidhje me këtë mundësi.

Neni 14

Autoritetet kompetente të Palëve të interesuara mund të bien dakord për të kryer një analizë ose monitorim post-projekti. Përmbajtja specifike e analizës së post-projektit duhet të bihet dakord ndërmjet tyre dhe në përputhje me legjislacionin e tyre kombëtar.

Neni 15

Nëse një Palë potencialisht e Cenuar dëshiron të njoftohet rreth një veprimtarie të propozuar, Pala e Cenuar dhe Pala e Origjinës duhet të hyjnë pa vonesë në konsultime, me qëllim gjetjen e një marrëveshjeje të përbashkët nëse aktiviteti i propozuar i nënshtrohet nenit 4.

Neni 16

Palët do të takohen me kërkesë me shkrim të çdo pale, me kusht që brenda 90 ditëve nga komunikimi i kërkesës, është mbështetur të paktën nga një Palë tjetër.

Neni 17

Anekset e kësaj Marrëveshjeje do të përbëjnë pjesë integrale të saj.

Neni 18

1. Çdo Palë mund të propozojë amendamente të kësaj Marrëveshjeje. Amendamentet e propozuara do t'i dorëzohen në formë të shkruar të gjitha Palëve .

2. Palët do të takohen në bazë të nenit 16 për të diskutuar amendamentet e propozuara.

3. Nenet 20 deri 24 do të zbatohen, *mutatis mutandis*, për ndryshime në këtë Marrëveshje, miratuar me konsensus ndërmjet palëve.

Neni 19

Kjo Marrëveshje do të jetë e hapur për nënshkrim në Bukuresht më 20 dhe 21 maj 2008.

Neni 20

Qeveria e Rumanisë do të veprojë si depozitari i kësaj Marrëveshjeje.

Neni 21

1. Kjo Marrëveshje do t'i nënshtrohet ratifikimit, pranimit ose miratimit nga shtetet nënshkruese.

2. Kjo Marrëveshje do të jetë e hapur për aderim nga data 22 maj 2008.

3. Instrumentet e ratifikimit, pranimit, miratimit ose aderimit do të depozitohen sa më shpejt të jetë e mundur pranë depozitarit. Depozitari duhet të informojë Palët për datën e depozitimit të çdo instrumenti të ratifikimit, pranimit, miratimit ose aderimit.

Neni 22

1. Kjo Marrëveshje do të hyjë në fuqi në ditën e tridhjetë pas datës së depozitimit të instrumentit të tretë të ratifikimit, pranimit, miratimit ose aderimit.

2. Për çdo shtet që ratifikon, pranon, miraton ose aderon në këtë Marrëveshje pas depozitimit të instrumentit të tretë të ratifikimit, pranimit, miratimit ose aderimit, Marrëveshja do të hyjë në fuqi në ditën e tridhjetë pas datës së depozitimit nga ky shtet të instrumenti të tij të ratifikimit, pranimit, miratimit ose aderimit.

Neni 23

Në çdo kohë, pas dy viteve nga data në të cilën kjo Marrëveshje ka hyrë në fuqi në lidhje me një Palë, kjo Palë mund të tërhiqet nga kjo Marrëveshje duke dhënë njoftimin me shkrim të depozitarit. Çdo tërheqje e tillë do të hyjë në fuqi në ditën e nëntëdhjetë pas datës së marrjes së tij nga depozitari. Çdo tërheqje e tillë nuk do të ndikojë në zbatimin e neneve 7 deri 13 për një aktivitet të propozuar në lidhje me të cilat njoftimi është kryer tashmë në përputhje me nenin 7, paragrafi 1, para hyrjes në fuqi të kësaj tërheqjeje.

Neni 24

Origjinali i kësaj Marrëveshjeje, versioni në gjuhën angleze i të cilës është teksti autentik, do të depozitohet pranë Qeverisë së Rumanisë.

Në dëshmi të kësaj, të poshtëshënuarit, duke qenë në mënyrë të rregullt të autorizuar, kanë nënshkruar këtë Marrëveshje.

Bërë në Bukuresht në ditën e njëzetë të muajit maj, dy mijë e tetë.

SHTOJCË

Informacioni i përmendur në nenin 7, paragrafi 4

1. Informacion mbi aktivitetin e propozuar:

a) Informacion për natyrën e aktivitetit të propozuar:

i) Lloji i aktivitetit të propozuar;

ii) Nëse aktiviteti i propozuar është i renditur në Shtojcën I të Konventës (po/jo);

iii) Qëllimi i aktivitetit të propozuar (p.sh. aktiviteti kryesor dhe ndonjë apo të gjitha aktivitetet periferike që kërkojnë vlerësim);

iv) Shkalla e aktivitetit të propozuar (p.sh., madhësia, kapaciteti i prodhimit);

v) Përshkrimi i aktivitetit të planifikuar (p.sh. teknologjia që përdoret);

vi) Përshkrimi i qëllimit të veprimtarisë së propozuar;

vii) Arsyeja për aktivitetin e propozuar (p.sh. baza socio-ekonomike, gjeografike-fizike);

viii) Informacione plotësuese dhe komentet.

b) Informacion mbi kufijtë hapësinorë dhe kohorë të veprimtarisë së propozuar:

i) Vendndodhja;

ii) Përshkrimi i vendndodhjes (p.sh. karakteri-stikat fiziko-gjeografike ose socio-ekonomike);

iii) Arsyeja për vendndodhjen e aktivitetit të propozuar (p.sh. baza socio-ekonomike apo fiziko-gjeografike);

iv) Afati kohor për aktivitetin e propozuar (p.sh. fillimi dhe kohëzgjatja e ndërtimit dhe operacionit);

v) Harta dhe dokumente të tjera të ilustruara të lidhura me informacionin mbi aktivitetin e propozuar;

vi) Informacione plotësuese dhe komente.

c) Informacion mbi ndikimet e pritshme mjedisore dhe masat lehtësuese të propozuara:

i) Qëllimi i vlerësimit (p.sh. shqyrtimi i ndikimeve kumulative, vlerësimi i alternativave, çështjet e zhvillimit të qëndrueshëm, ndikimi i aktiviteteve periferike);

ii) Ndikimet e pritura mjedisore të aktivitetit të propozuar (p.sh. llojet, vendet, madhësitë);

iii) Inputet (p.sh., uji, toka, materiale të papërpunuara, burimet e energjisë);

iv) Rezultatet (p.sh. shumat dhe llojet e emetimeve në atmosferë, shkarkimet në sistemin e ujit, mbetjeve të ngurta);

v) Ndikimet ndërkufitare (p.sh. llojet, vendndodhja, madhësitë);

vi) Masat lehtësuese të propozuara (p.sh. nëse dihet, masat lehtësuese për të parandaluar, eliminuar, minimizuar dhe kompensuar ndikimet mjedisore);

vii) Informacione plotësuese dhe komente.

d) Përmbledhja dhe koha e konsultimit të propozuar, duke përfshirë një përmbledhje të procesit të ankesës apo procedurës së ankimit;

e) Propozuesi ose zhvilluesi (detajet e personit të kontaktit):

i) Emri, adresa, numrat e telefonit dhe faksit;

f) Vlerësimi i ndikimit mjedisor (VNM), dokumentacioni dhe procedura:

i) nëse dokumentacioni i VNM-së (p.sh. raporti VNM-së apo Deklarata e Ndikimit Mjedisor) është përfshirë në njoftimin (Po/Jo/pjesërisht);

ii) Nëse jo, ose pjesërisht, nëse përshkrimi i dokumentacionit shtesë duhet të dërgohet dhe, nëse po (përafërsisht) data/t kur dokumentacioni do të jetë në dispozicion;

iii) Planifikimi kohor;

iv) Detajet e personit të kontaktit (Pala e Origjinës);

v) Autoriteti përgjegjës për koordinimin e aktiviteteve që lidhen me procedurën e vlerësimit të

ndikimit mjedisor;

vi) Emri, adresa, numrat e telefonit dhe faksit;

vii) Informacione plotësuese dhe komente.

2. Pikat e kontaktit:

a) Pikat e kontaktit për Palët e mundshme të Cenuara:

i) Autoriteti përgjegjës për koordinimin e aktiviteteve qe lidhen me VNM-në; me emër, adresë, numrat e telefonit dhe faksit;

ii) Lista e Palëve të Cenuara tek të cilat është dërguar njoftimi;

b) Pikat e kontaktit për Palën e Origjinës:

i) Autoriteti përgjegjës për koordinimin e aktiviteteve në lidhje me VNM-në, me emër, adresë, numrat e telefonit dhe faksit;

ii) Autoriteti vendimmarrës, nëse është i ndryshëm nga autoriteti përgjegjës për koordinimin e aktiviteteve që lidhen me VNM-në, me emrin, adresën, numrat e telefonit dhe faksit.

3. Informacion mbi procesin e vlerësimit të ndikimit mjedisor në Palën e Origjinës që do të zbatohet për aktivitetin e propozuar:

a) Planifikimi kohor;

b) Mundësi për Palën e Cenuar apo palët që do të përfshihen në procesin e VNM-së;

c) Mundësi për palë të prekur ose palë që të rishikojnë dhe komentojnë njoftimin dhe dokumentacionin e VNM-së;

d) Natyra dhe koha e vendimeve të mundshme;

e) Procesi për miratimin e veprimtarisë së propozuar;

f) Informacione dhe komente shtesë.

4. Informacion mbi procesin e pjesëmarrjes së publikut të Palës së Origjinës:

a) procedurat e pjesëmarrjes së publikut;

b) fillimin e pritshëm dhe kohëzgjatjen e konsultimit publik;

c) Informacione dhe komente shtesë.

5. Afati për përgjigje.